

SONY®

4-477-083-42(2) (AL)

Fotoaparāt dixhital

Udhēzues

Cyber-shot



DSC-RX10

Më tepër rreth kamerës („Udhëzuesi i ndihmës“)




„Udhëzuesi i ndihmës“ është manual në internet.

Drejtojuini për udhëzime të hollësishtme mbi shumë funksione të kamerës.

- ① Hapni faqen e mbështetjes Sony.
<http://www.sony.net/SonyInfo/Support/>
- ② Zgjidhni shtetin ose rajonin tuaj.
- ③ Kërkoni për emrin e modelit të kamerës suaj brenda faqes së mbështetjes.
 - Kontrolloni emrin e modelit në fund të kamerës.


Shikimi i udhëzuesit

Kjo kamerë është e pajisur me një udhëzues të integruar.



Udhëzuesi i integruar

Kamera shfaq shpjegimet për artikujt e MENU dhe vlerat e cilësimet.

- ① Shtypni butonin MENU ose butonin Fn (Funksioni).
- ② Zgjidhni artikullin e dëshiruar, më pas shtypni butonin  (Fshi).

Regjistri i zotëruesit

Modeli dhe numrat serialë ndodhen në pjesën e poshtme. Regjistroni numrin serial në hapësirën e dhënë më poshtë. Referojuni këtyre numrave sa herë që kontaktoni me shitësin tuaj Sony në lidhje me këtë produkt.

Numri i modelit WW808143 (DSC-RX10)

Numri i serisë _____

Numri i modelit AC-UB10/AC-UB10B/AC-UB10C/AC-UB10D

Numri i serisë _____

DSC-RX10 Numri i modelit WW808143

PARALAJMËRIM

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, njësia nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

AL

UDHËZIME TË RËNDËSISHME MBI SIGURINË -RUAJINI KËTO UDHËZIME

RREZIK

PËR TË ZVOGËLUAR RREZIKUN E ZJARRIT OSE TË GODITJEVE ELEKTRIKE, NDIQNI ME KUJDES KËTO UDHËZIME

Nëse forma e spinës nuk përputhet me formën e prizës, përdorni përshtatës spine me konfigurimin e duhur për prizën.

KUJDES

| Paketa e baterisë

Nëse paketa e baterisë keqpërdoret, ajo mund të shpërthejë, duke shkaktuar zjarr ose edhe djegie kimike. Zbatoni masat paraprake të mëposhtme.

- Mos e çmontoni.
- Mos e shtypni dhe mos e ekspozoni paketën e baterisë ndaj ndonjë goditjeje apo force si goditje me çekiç, rënie apo shkelje të saj.
- Mos shkaktoni qark të shkurtër dhe mos lejoni që objektet metalike të bien në kontakt me terminalet e baterisë.
- Mos e ekspozoni ndaj temperaturave të larta mbi 60°C (140°F) si p.sh. në dritë të drejtpërdrejtë dielli apo në një makinë të parkuar në diell.
- Mos e digjni ose mos e ekspozoni atë në zjarr.

- Mos përdorni bateri litium-jon të dëmtuara apo që rrjedhin.
- Sigurohuni që të karikoni paketën e baterisë duke përdorur një karikues original Sony ose një pajisje që mund të karikojë paketën e baterisë.
- Mbajeni paketën e baterisë larg nga fëmijët e vegjël.
- Mbajeni të thatë paketën e baterisë.
- Zëvendësojeni vetëm me të njëjtin lloj ose me një lloj ekuivalent të rekomanduar nga Sony.
- Hidhini paketat e përdorura të baterive siç përshkruhet në udhëzime.

Ushqyesi

Përdorni prizën më të afërt të murit kur përdorni ushqyesin. Shkëputeni menjëherë ushqyesin nga priza e murit nëse ndodh ndonjë keqfunksionim gjatë përdorimit të aparaturës.

Për klientët në Evropë

Shënim për klientët në vendet ku vlejnë direktivat e BE-së

Prodhuesi: Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japan
 Për pajtueshmërinë e produktit me BE-në: Sony Deutschland GmbH,
 Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Germany



Përmes kësaj, Sony Corporation, deklaron se ky Fotoaparat dixhital WW808143 është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat e tjera përkatëse të direktivës 1999/5/KE. Për hollësi, vizitoni adresën e mëposhtme:
<http://www.compliance.sony.de/>

Shënim

Nëse elektriciteti apo elektromagnetizmi statik shkakton ndërprerjen (dështimin) e transferimit të të dhënave, rihapni aplikacionin ose shkëputni dhe lidhni kablloin e komunikimit (USB etj.).

Ky produkt është testuar dhe rezulton në pajtim me kufijtë e përcaktuar në rregulloren për pajisjet elektromagnetike për përdorimin e kabllove lidhëse nën 3 metra (9,8 këmbë).

Fushat elektromagnetike në frekuencat specifike mund të ndikojnë në figurën dhe zërin e kësaj njësie.

I Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe shtetet e tjera evropiane me sistem të diferencuar grumbullimi)



Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më

shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

I Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)



Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria që vjen me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake.

Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zivë ose 0,004% plumb.

Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkomporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzoheni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti.

Dorëzoheni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.


Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.


Kontrollimi i artikujve të dhënë



Numri në kllapa tregon numrin e pjesëve.

- Kamera (1)
- Paketë baterie e rikarikueshme NP-FW50 (1)
- Kabllo mikro USB (1)
- Ushqyes AC-UB10/UB10B/UB10C/UB10D (1)
- Kordoni elektrik (nuk jepet në SHBA dhe në Kanada) (1)
- Rripi i supit (1)
- Kapaku i objektivit (1)
- Mbrojtësja e lentes (1)
- Kapaku i kapëses (1) (montuar në kamerë)
- Kupa e okularit (1) (montuar në kamerë)
- Udhëzues (ky udhëzues) (1)


Identifikimi i pjesëve





- 1 Çelësi ON/OFF (Energjia)
- 2 Butoni i diafragmës
- 3 Për regjistrim: Instrumenti W/T (zmadhimi)
Për shikim: Instrumenti  (Indeksi) / Instrumenti i zmadhimit të riprodhimit
- 4 Llambushka me fikje automatike / Drita ndihmëse e fokusimit automatik
- 5 Indeksi i aperturës
- 6 Objektivi
- 7 Unaza manuale
 - Ju mund të zmadhoni duke përdorur unazën manuale kur jeni në modalitetin Auto Focus. Ju mund të përshtatni fokusin duke përdorur unazën manuale kur ndodheni në modalitetin Manual Focus ose në modalitetin Direct Manual Focus.
- 8 Graduesi i kompensimit të ekspozimit
- 9 Blici
- 10 Kapëse MIS*


- 11 Graduesi i modaliteteve **AUTO** (Auto Mode)/ **P** (Program Auto)/ **A** (Aperture Priority)/ **S** (Shutter Priority)/ **M** (Manual Exposure)/ **1/2** (Memory recall)/  (Movie)/  (Sweep Panorama)/ **SCN** (Scene Selection)

- 12 Kapësja për rripin e supit
- 13 Graduesi i modalitetit të fokusimit
- 14 Unaza e aperturës




- 1 Butoni  (Ekrani/ndriçimi i panelit)
- 2 Mikrofoni
- 3 Treguesi i kuadrit
- 4 Graduesi i dioptrisë
- 5 Butoni MOVIE (Filmim)
- 6 Butoni  (Dalja e blicit)
- 7 Paneli i ekranit
- 8 Butoni C (i personalizuar)

- 9 Kapësja për rripin e supit
- 10 Foleja e kartës së memories
- 11 Kapaku i kartës së memories
- 12 Llambushka e aksesit




- 1 Butoni MENU
- 2 Altoparlanti
- 3 Foleja m (e mikrofonit)
 - Kur lidhet një mikrofon i jashtëm, kamera kalon nga mikrofoni i brendshëm në mikrofonin e jashtëm. Nëse mikrofoni i jashtëm është i llojit me rrymë nga fisha, rryma merret nga kamera.
- 4 Foleja (e kufjeve)
- 5 Multiterminali
 - Mbështet pajisje me Micro USB.
- 6 Mikrofoleja HDMI
- 7 Llambushka e karikimit
- 8 Sensori i dritës
- 9 Ekрани LCD
- 10 Rrotulla e komandimit
- 11 Graduesi i komandimit

- 12 Për regjistrim: Butoni AEL (bllokimi AE)
Për shikim: Butoni (Zmadhimi i riprodhimit)
- 13 Për regjistrim: Butoni Fn (Funksioni)
Për shikim: Butoni (Dërgo në smartphone)
- 14 Butoni (Fshi/Udhëzuesi i integruar)
- 15 Butoni (luajtje)



- 1 Çelësi me klikim i aperturës
 - Vendosni çelësin me klikim të aperturës në OFF kur regjistroni filmime. Nëse ndryshoni vlerën e aperturës gjatë regjistrimit të një filmimi me çelësin me klikim të aperturës të vendosur në ON, do të regjistrohet zhurma e unazës së aperturës.
- 2 Sensori Wi-Fi (i integruar)

- 3** **N** (Shenja N)
- Prekni shenjën kur lidhni kamerën me një telefon smartphone të pajisur me funksionin NFC.
 - NFC (Near Field Communication) është një teknologji standarde ndërkombëtare komunikimi me valë me rreze të shkurtër.
- 4** Instrumenti i nxjerrjes së baterisë
- 5** Foleja e futjes së baterisë
- 6** Kapaku i pllakës së lidhjes
- Përdorni këtë kur përdorni ushqyes AC-PW20 (shitet veçmas). Futeni pllakën e lidhjes në folenë e baterisë dhe kalojeni kordonin përgjatë kapakut të pllakës së lidhjes siç tregohet më poshtë.



- Sigurohuni që kordoni të mos kapet kur mbyllni kapakun.
- 7** Kapaku i baterisë
- 8** Vrima e folesë së këmbalecit
- Përdorni këmbalec me vidë nën 5,5 mm (7/32 inç). Përndryshe, nuk do të mund ta siguron kamerën dhe mund ta dëmtoni.


* Për hollësi mbi aksesoret e mbështetur nga kapësja MIS, vizitoni faqen e Sony ose konsultohuni me shitësin e Sony ose pikën e autorizuar lokale të shërbimit të Sony. Gjithashtu mund të përdorni aksesorë që përputhen me kapësen MIS. Funksionimi nuk garantohej me aksesorë të prodhuesve të tjerë.

ni Multi
Interface Shoe

Accessory Shoe

AL

Futja e paketës së baterisë




1 Mbyllni kapakun.

2 Futni paketën e baterisë.



- Ndërsa shtypni instrumentin e nxjerrjes së baterisë, futeni paketën e baterisë si në ilustrim. Sigurohuni që instrumenti i nxjerrjes së baterisë të ngecë pas futjes.
- Mbyllja e kapakut me baterinë të futur gabim, mund të dëmtojë kamerën.

Karikimi i paketës së baterisë

Për klientët në SHBA
dhe në Kanada



Për klientët në shtete/rajone të tjera
ndryshe nga SHBA-ja dhe Kanadaja



AL

1 Lidhni kamerën me ushqyesin (jepet), duke përdorur kabllon mikro USB (jepet).

2 Futeni ushqyesin në prizën e murit.

Llambushka e karikimit ndizet në të portokalltë dhe fillon karikimi.

- Fikni kamerën gjatë karikimit të baterisë.
- Paketën e baterisë mund ta karikoni edhe nëse ajo është pjesërisht e karikuar.
- Kur llambushka e karikimit pulson dhe karikimi nuk ka mbaruar, hiqeni dhe rivendoseni paketën e baterisë.

Shënime

- Nëse llambushka e karikimit në kamerë pulson kur ushqyesi futet në prizë, kjo tregon se karikimi ka ndaluar për momentin pasi temperatura është jashtë diapazonit të rekomanduar. Karikimi rifillon kur temperatura të kthehet brenda diapazonit të përshtatshëm. Rekomandojmë karikimin e paketës së baterisë në temperaturë ambiente midis 10°C deri në 30°C (50°F deri në 86°F).
- Paketa e baterisë mund të mos karikohet me efikasitet nëse pjesa e terminaleve të baterisë është e ndotur. Në këtë rast, fshini çdo papastërti me butësi duke përdorur një pëlhurë të butë ose një tampon pambuku për të pastruar pjesën e terminaleve të baterisë.
- Futeni ushqyesin (jepet) në prizën më të afërt. Nëse ndodhin probleme gjatë përdorimit të ushqyesit, shkëputeni menjëherë nga priza për ta hequr nga burimi i energjisë.
- Hiqeni ushqyesin nga priza pasi të mbarojë karikimi.
- Sigurohuni të përdorni vetëm paketa baterish, kablllo mikro USB (jepet) dhe ushqyes (jepet) autentikë të markës Sony.
- Energjia nuk furnizohet gjatë regjistrimit/riprodhimit nëse kamera është e lidhur me një prizë muri me ushqyesin e dhënë. Për të furnizuar me energji kamerën gjatë regjistrimit/riprodhimit, përdorni ushqyesin AC-PW20 (shitet veçmas).

■ Koha e karikimit (karikim i plotë)


Koha e karikimit është afro 310 min. me ushqyes (jepet).

Shënime

- Koha e mësipërme e karikimit vlen për karikim pakete baterie të shkarkuar plotësisht në temperaturë 25°C (77°F). Karikimi mund të kërkojë më shumë në varësi të kushteve të përdorimit apo të rrethanave të caktuara.

■ Karikimi me lidhje me kompjuterin

Paketa e baterisë mund të karikohet duke lidhur kamerën në kompjuter me anë kabloje mikro USB.



Shënime

- Kini parasysh pikat e mëposhtme kur karikoni nga kompjuteri:
 - Nëse kamera lidhet me një laptop që nuk është në prizë, do të bjerë niveli i baterisë së laptopit. Mos e karikoni për një periudhë të gjatë kohe.
 - Mos e ndizni/fikni kompjuterin, as mos e nxirrni kompjuterin nga gjendja e fjetjes nëse ka lidhje USB midis kompjuterit dhe kamerës. Kjo mund t'i shkaktojë kamerës defekt. Shkëputni kamerën nga kompjuteri përpara se ta fikni, ndizni, rindizni ose nxirrni kompjuterin nga fjetja.
 - Nuk jepet asnjë garanci për karikimin me kompjuterë të krijuar vetë ose të modifikuar.

AL



■ Jetëgjatësia e baterisë dhe numri i imazheve që mund të regjistrohen dhe riprodhohen

		Jetëgjatësia e baterisë	Numri i imazheve
Regjistrimi (imazhe statike)	Ekrani LCD	Afërsisht 210 min.	Afërsisht 420 imazhe
	Treguesi i kuadrit	Afërsisht 170 min.	Afërsisht 340 imazhe
Regjistrim tipik për filmime	Ekrani LCD	Afërsisht 70 min.	—
	Treguesi i kuadrit	Afërsisht 70 min.	—
Regjistrim i vazhdueshëm për filmim	Ekrani LCD	Afërsisht 145 min.	—
	Treguesi i kuadrit	Afërsisht 145 min.	—
Shfaqja (imazhe statike)		Afërsisht 315 min.	Afërsisht 6300 imazhe

Shënime

- Numri i mësipërm i imazheve vlen kur paketa e baterisë është tërësisht e karikuar. Numri i imazheve mund të bjerë në varësi të kushteve të përdorimit.
- Numri i imazheve që mund të regjistrohen është për regjistrim në kushtet si më poshtë:
 - Përdorimi i Media „Memory Stick PRO Duo“ (Mark2) Sony (shitet veçmas)
 - Paketa e baterisë përdoret në temperaturë ambienti prej 25°C (77°F).
 - [Display Quality] është vendosur në [Standard]
- Numri për „Regjistrime (imazhe statike)“ mbështetet mbi standardin CIPA dhe është për regjistrim në kushtet si më poshtë: (CIPA: Camera & Imaging Products Association)
 - DISP është vendosur në [Display All Info.].
 - Një regjistrim çdo 30 sekonda.
 - Zmadhimi kalon në mënyrë të alternuar mes fundeve W dhe T.
 - Blici shkrepet një herë çdo dy herë.
 - Pajisja ndizet dhe fiket një herë në çdo dhjetë herë.
- Numri i minutave për filmim mbështetet mbi standardin CIPA dhe është për regjistrim në kushtet si më poshtë:
 - [Record Setting]: 60i 17M(FH)/50i 17M(FH)
 - Regjistrim tipike për filmime: Jetëgjatësia e baterisë bazuar në nisjen/ndalimin e vazhdueshëm, zmadhimin, fikje/ndezje etj.
 - Regjistrim i vazhdueshëm për filmim: Jetëgjatësia e baterisë për regjistrim pa ndalesa deri në kapjen e cakut (29 minuta) dhe e vazhduar duke rishtypur butonin MOVIE. Funksione të tjera, si zmadhimi, nuk përdoren.

Futja e një karte memorieje (shitet veçmas)



Sigurohuni që këndi i prerë të jetë në drejtimin e duhur.

1 Mbyllni kapakun.

2 Fusni kartën e memories (shitet veçmas).

- Me këndin e prerë sipas drejtimit në figurë, futeni kartën e memories derisa të ngecë në vend.

3 Mbyllni kapakun.

AL

Kartat e memories që mund të përdoren

	Kartë memorieje	Për imazhe statike	Për filmime
A	Memory Stick XC-HG Duo	✓	✓
	Memory Stick PRO Duo	✓	✓ (vetëm Mark2)
	Memory Stick PRO-HG Duo	✓	✓
B	Memory Stick Micro (M2)	✓	✓ (vetëm Mark2)
C	Kartë memorieje SD	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
	Kartë memorieje SDHC	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
	Kartë memorieje SDXC	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
D	Kartë memorieje microSD	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
	Kartë memorieje microSDHC	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)
	Kartë memorieje microSDXC	✓	✓ (Kategoria 4 ose më e shpejtë)

- Në këtë udhëzues produktet në tabelë përmenden të gjitha bashkë si më poshtë:
A: Media „Memory Stick PRO Duo“
B: Media „Memory Stick Micro“
C: Karta SD
D: Kartë memorieje microSD

Shënime

- Kur përdorni një media „Memory Stick Micro“ ose karta memorieje microSD me këtë kamera, sigurohuni t'i përdorni me përshtatësin e duhur.

Për ta hequr kartën e memories / paketën e baterisë


Karta e memories: Shtyni kartën e memories një herë për ta nxjerrë kartën e memories.

Paketa e baterisë: Rrëshqisni instrumentin e nxjerrjes së baterisë. Sigurohuni të mos e hidhni përtokë paketën e baterisë.

Shënime

- Mos e hiqni asnjëherë kartën e memories / paketën e baterisë kur llambushka e aksesit (faqe 7) është e ndezur. Kjo mund të shkaktojë dëmtim të të dhënave në kartën e memories.


Vendosja e orës



- 1** Vendosni çelësin ON/OFF (Energjia) në ON.
Cilësimi i orës dhe datës shfaqet kur ndizni kamerën për herë të parë.
 - Mund të duhet pak kohë që energjia të ndizet dhe të lejojë veprimin.
- 2** Kontrolloni që të zgjidhet [Enter] në ekran, pastaj shtypni ● në rrotullën e komandimit.
- 3** Zgjidhni vendndodhjen e dëshiruar gjeografike duke ndjekur udhëzimet në ekran dhe shtypni ●.
- 4** Vendosni [Daylight Savings], [Date/Time] dhe [Date Format], më pas shtypni ●.
 - Kur vendosni [Date/Time], mesnata është 12:00 AM, dhe mesdita është 12:00 PM.
- 5** Kontrolloni që të zgjidhet [Enter] pastaj shtypni ●.

AL

Regjistrimi i imazheve statike/Filmimi



Regjistrimi i imazheve statike

- 1 Për të fokusuar shtypni butonin e diafragmës deri në gjysmë. Kur imazhi është në fokus, bie në tingull dhe ● ose ndriçon treguesi (●).
- 2 Për të regjistruar një imazh shtypni butonin e diafragmës deri në fund.


Regjistrimi i filmimeve

- 1 Shtypni butonin MOVIE (Filmim) për të nisur regjistrimin.
 - Përdorni instrumentin W/T (zmadhimi) për të ndryshuar shkallën e zmadhimit.
- 2 Shtypni butonin MOVIE sërish për të ndaluar regjistrimin.

Shënime

- Mos e ngrini blicin lart manualisht. Kjo mund të shkaktojë defekt.
- Kur përdorni funksionin e zmadhimit gjatë regjistrimit të një filmi, do të regjistrohet tingulli i kamerës gjatë punës. Tingulli i butonit MOVIE gjatë punës mund të regjistrohet gjithashtu kur përfundon regjistrimi i filmimit.
- Filmimi i vazhdueshëm është i mundur për rreth 29 minuta njëkohësisht, me cilësimet e parazgjedhura të kamerës dhe kur temperatura e ambientit është afërsisht 25°C (77°F). Kur përfundon regjistrimi i filmimit, mund të rifilloni regjistrimin duke shtypur sërish butonin MOVIE. Regjistrimi mund të ndalojë për të mbrojtur kamerën në varësi të temperaturës së ambientit.

Shikimi i imazheve



1 Shtypni butonin ▶ (Riprodhimi).

■ Zgjedhja e imazhit përpara/prapa

Zgjidhni një imazh duke shtypur ► (tjetër)/◄ (e mëparshme) në rrotullën e komandimit ose duke rrotulluar rrotullën e komandimit. Shtypni ● në mes të rrotullës së komandimit për të parë filmimet.

■ Fshirja e një imazhi

- 1 Shtypni butonin 🗑️ (Fshi).
- 2 Zgjidhni [Delete] me ▲ në rrotullën e komandimit dhe shtypni ●.


■ Kthimi te regjistrimi i imazheve

Shtypni butonin e diafragmës deri në gjysmë.

AL

Prezantimi i funksioneve të tjera

Funksionet e tjera mund të përdoren duke përdorur rrotullën e komandimit, butonin MENU etj.



■ Rrotulla e komandimit

DISP (Shfaq përmbajtjen): Ju lejon të ndryshoni pamjen në ekran.

● (Eye AF): Fokusoheh në sytë e një personi kur shtypni butonin. Regjistroni imazhe duke shtypur butonin e diafragmës gjatë kohës që shtypet ●.

■ Butoni Fn (Funksioni)

Ju lejon të regjistroni 12 funksione dhe të riktheni ato funksione kur regjistroni.







- ① Shtypni butonin Fn (Funksioni).
- ② Zgjidhni funksionin e dëshiruar duke shtypur ▲/▼/◀/▶ në rrotullën e komandimit.
- ③ Zgjidhni vlerën e cilësimit duke rrotulluar rrotullën e komandimit.









■ Graduesi i komandimit

Ju mund ta ndryshoni në çast cilësimin e duhur për secilin modalitet regjistrimi duke rrotulluar graduesin e komandimit.

■ Artikujt e menysë



📷 (Camera Settings)



 Image Size	Zgjedh madhësinë e figurës për imazhet statike.
 Aspect Ratio	Zgjedh raportin e pamjes për imazhet statike.
 Quality	Vendos cilësinë e imazhit për imazhet statike.
Panorama: Size	Zgjedh madhësinë e figurës për imazhet panoramike.
Panorama: Direction	Vendos drejtimin e regjistrimit për imazhet panoramike.
 File Format	Zgjedh formatin e skedarit të filmimit
 Record Setting	Zgjedh madhësinë e kuadrit të filmimit të regjistruar.
Drive Mode	Vendos modalitetin e lëvizjes, si p.sh. për regjistrimin e vazhdueshëm.
Flash Mode	Vendos cilësimet e blicit.
Flash Comp.	Përshtat intensitetin e daljes së blicit.
Red Eye Reduction	Redukton fenomenin e syve të kuq duke përdorur blicin.
Focus Area	Zgjedh zonën e fokusimit.
 AF Illuminator	Vendos dritën ndihmëse të fokusimit automatik, i cili siguron dritë për një skenë të errët për të ndihmuar fokusimin.
ISO	Përshtat ndjeshmërinë e ndriçimit.
ND Filter	Vendos funksionin që redukton sasinë e dritës. Ju mund të vendosni një shpejtësi më të ulët të diafragmës, të reduktoni vlerën e aperturës, etj.
Metering Mode	Zgjidhni modalitetin e matjes që vendos se cila pjesë e subjektit matet për të përcaktuar ekspozimin.
White Balance	Përshtat tonalitetin e ngjyrave të një imazhi.
DRO/Auto HDR	Kompenso automatikisht ndriçimin dhe kontrastin.
Creative Style	Zgjedh përpunimin e imazhit të dëshiruar.
Picture Effect	Zgjedh filtrin e efektit të dëshiruar për të arritur një shprehje më mbresëlënëse dhe artistike.

Focus Magnifier	Zmadhon imazhin përpara regjistrimit në mënyrë që të mund të shihni fokusin në detaje.
 Long Exposure NR	Vendos përpunimin e reduktimit të zhurmës për regjistrimet me shpejtësi diafragme prej 1/3 sekonde ose më shumë.
 High ISO NR	Vendos përpunimin e reduktimit të zhurmës për regjistrime me ndjeshmëri të lartë.
Lock-on AF	Vendos funksionin për të gjurmuar subjektin dhe për të vazhduar fokusimin.
Smile/Face Detect.	Zgjedh diktimin e fytyrave dhe përshtat automatikisht cilësimet të shumëllojshme. Vendos të hapë automatikisht diafragmën kur diktohet një buzëqeshje.
 Soft Skin Effect	Vendos Soft Skin Effect dhe nivelin e efektit.
 Auto Obj. Framing	Analizon skenën kur fotografon fytyra, pamje nga afër ose subjekte të gjurmuara nga funksioni Lock-on AF dhe shkurton automatikisht dhe ruan një kopje tjetër të imazhit me kompozim më mbresëlënës.
Auto Mode	Mund të regjistroni duke zgjedhur Intelligent Auto ose Superior Auto.
Scene Selection	Zgjedh cilësimet e paravendosura për t'iu përpatur me kushte të ndryshme të skenës.
Movie	Zgjedh modalitetin e ekspozimit për t'iu përshtatur subjektit ose efektit.
 SteadyShot	Vendos SteadyShot për regjistrimin e imazheve statike. Redukton turbullirën nga tundja e kamerës kur regjistroni me kamerën në dorë.
 SteadyShot	Vendos SteadyShot për regjistrimin e filmimeve.
 Color Space	Ndryshon gamën e ngjyrave të riprodhueshme.
 Auto Slow Shut.	Vendos funksionin që përshtat automatikisht shpejtësinë e diafragmës duke lejuar ndriçimin e ambientit.
Audio Recording	Vendos nëse do të regjistrohet audioja kur regjistrohet një filmim.
Audio Rec Level	Përshtat nivelin e regjistrimit të audios gjatë regjistrimit të një filmimi.

Audio Out Timing	Vendos kohën e shkurtimit të daljes së audios gjatë regjistrimit të filmimit.
Wind Noise Reduct.	Redukton zhurmën e erës gjatë regjistrimit të filmimit.
Memory	Regjistron modalitetet e dëshiruara ose cilësimet e kamerës.

(Custom Settings)

Zebra	Shfaq shirita për të përshtatur ndriçimin.
 MF Assist	Shfaq një imazh të zmadhuar kur fokusohet manualisht.
Focus Magnif. Time	Vendos kohëzgjatjen e shfaqjes së imazhit në formë të zmadhuar.
Grid Line	Vendos një ekran me rrjetë për të mundësuar drejtvendosjen sipas një skice strukturore.
Audio Level Display	Vendos nëse shfaqet ose jo niveli i audios në ekran.
Auto Review	Vendos rishikimin automatik për të shfaqur imazhin e kapur pas regjistrimit.
DISP Button	Vendos modalitetet e shfaqjes në ekran që mund të zgjidhen duke shtypur DISP në rrotullën e komandimit.
Peaking Level	Përmirëson skicën e gamave në fokus me një ngjyrë specifike kur fokusohet manualisht.
Peaking Color	Vendos ngjyrën e përdorur për funksionin e kulmimit.
Exposure Set. Guide	Vendos udhëzuesin e shfaqur kur ndryshohen ekspozimet në ekranin e regjistrimit.
Live View Display	Vendos nëse do të reflektohen apo jo cilësimet e tilla si kompensimi i ekspozimit në ekran.
 Pre-AF	Vendos nëse do të kryhet apo jo fokusimi automatik përpara se butoni i diafragmës të jetë shtypur deri në gjysmë.
Zoom Setting	Vendos nëse do të përdoret apo jo zmadhimi me qartësim figure dhe zmadhimi dixhital gjatë zmadhimit.

FINDER/MONITOR	Vendos metodën për kalimin nga treguesi i kuadrit te ekrani.
 AEL w/ shutter	Vendos nëse do të kryhet AEL kur butoni i diafragmës shtypet deri në gjysmë.
Exp.comp.set	Vendos nëse do të reflektohet vlera e kompensimit të ekspozimit në kompensimin e blicit.
Bracket order	Vendos rendin e regjistrimit për kllapën e ekspozimit dhe kllapën e balancës së të bardhës.
Face Registration	Regjistron apo ndryshon personin të cilit do t'i jepet prioritet në fokus.
 Write Date	Vendos nëse do të regjistrohet një datë e regjistrimit mbi imazhin statik.
Function Menu Set.	Personalizon funksionet e shfaqura kur shtypet butoni Fn (Funksioni).
Custom Key Settings	Cakton një funksion të dëshiruar për butonin dhe graduesin.
Zoom Func. on Ring	Vendos funksionin e zmadhimit të unazës manuale. Kur zgjidhni [Step], mund të lëvizni pozicionin e zmadhimit në një hap fiks të gjatësisë së fokusimit.
MOVIE Button	Vendos nëse do të aktivizohet gjithmonë butoni MOVIE.
Dial/Wheel Lock	Vendos nëse do të çaktivizohet përkohësisht graduesi i komandimit dhe rrotulla e komandimit duke përdorur butonin Fn gjatë regjistrimit. Ju mund të çaktivizoni/aktivizoni graduesin e komandimit dhe rrotullën e komandimit duke mbajtur shtypur butonin Fn.


(Wireless)


Dërgo në smartphone	Transferon imazhe për shfaqje në një telefon smartphone.
Send to Computer	Rezervon imazhet duke i transferuar ato në një kompjuter të lidhur me një rrjet.
View on TV	Imazhet mund t'i shikoni në një televizor të lidhur me rrjetin.

Ctrl w/ Smartphone	Regjistron imazhe statike duke kontrolluar kamerën në distancë me një telefon smartphone.
Airplane Mode	Mund ta vendosni këtë pajisje të mos kryejë komunikime me valë.
WPS Push	Ju mund të regjistroni pikën e aksesit të kamerës me lehtësi duke shtypur butonin WPS.
Access Point Set.	Ju mund ta regjistroni manualisht pikën tuaj të aksesit.
Edit Device Name	Ju mund ta ndryshoni emrin e pajisjes te Wi-Fi Direct, etj.
Disp MAC Address	Shfaq adresën MAC të kamerës.
SSID/PW Reset	Rivendos SSID dhe fjalëkalimin e lidhjes së smartphone.
Reset Network Set.	Rivendos të gjitha cilësimet e rrjetit.


AL

(Playback)

Delete	Fshin një imazh.
View Mode	Vendos mënyrën e grupimit të imazheve për riprodhim.
Image Index	Shfaq disa imazhe njëkohësisht.
Display Rotation	Vendos drejtimin e riprodhimit të imazhit të regjistruar.
Slide Show	Shfaq një pamje rrëshqitëse.
Rotate	Rrotullon imazhin.
 Enlarge Image	Zmadhon imazhet e riprodhuara.
4K Still Image PB	Nxjerr imazhe statike në rezolucion 4K me një televizor të lidhur me HDMI që mbështet 4K.
Protect	Mbron imazhet.
Specify Printing	Shton një shenjë printimi në një imazh statik.

 (Setup)

Monitor Brightness	Vendos ndriçimin e ekranit.
Viewfinder Bright.	Kur përdorni një tregues elektronik kuadri, vendos ndriçimin e treguesit elektronik të kuadrit.
Finder Color Temp.	Vendos temperaturën e ngjyrës së treguesit të kuadrit.
Volume Settings	Vendos volumin për riprodhimin e filmimit.
Audio signals	Vendos tingullin e punës së kamerës.
Upload Settings	Vendos funksionin e ngarkimit të kamerës kur përdorni një kartë Eye-Fi.
Tile Menu	Vendos nëse do të shfaqet menyuja me kuadrate sa herë që shtypni butonin MENU.
Mode Dial Guide	Aktivizon ose çaktivizon udhëzuesin e graduesit (shpjegimin për çdo modalitet regjistrimi).
Delete confirm.	Vendos se cili nga Delete ose Cancel parazgjidhet në ekranin e konfirmimit të fshirjes.
Display Quality	Vendos cilësinë e ekranit.
Pwr Save Start Time	Vendos kohëzgjatjen derisa kamera të fiket automatikisht.
PAL/NTSC Selector (vetëm për modelet e pajtueshme me 1080 50i)	Duke ndryshuar formatin e televizorit të pajisjes, është i mundur regjistrimi në një format tjetër filmimi.
Demo Mode	Aktivizon/çaktivizon riprodhimin e demonstrimit të një filmimi.
HDMI Resolution	Vendos rezolucionin kur kamera është e lidhur me një televizor HDMI.
CTRL FOR HDMI	Përdor kamera nga një televizor që mbështet „BRAVIA“ Sync.
HDMI Info. Screen	Zgjedh nëse do të shfaqet apo jo informacioni në televizor gjatë kohës që lidhet me një televizor të pajtueshëm HDMI.
USB Connection	Vendos metodën e lidhjes USB.
USB LUN Setting	Përmirëson pajtueshmërinë duke kufizuar funksionet e lidhjes USB.

 Language	Zgjedh gjuhën.
Date/Time Setup	Vendos datën dhe orën, dhe orën verore dhe dimërore.
Area Setting	Vendos vendndodhjen e përdorimit.
Format	Formaton kartën e memories.
File Number	Vendos metodën e përdorur për të caktuar numrat e skedarëve të imazheve statike dhe filmimeve.
Select REC Folder	Ndryshon dosjen e zgjedhur për ruajtjen e imazheve.
New Folder	Krijon një dosje të re për të ruajtur imazhe statike dhe filmime (MP4).
Folder Name	Vendos formatin e dosjes për imazhet statike.
Recover Image DB	Rikuperon skedarin e databazës së imazhit dhe aktivizon regjistrimin dhe riprodhimin.
Display Media Info.	Shfaq kohën e mbetur të regjistrimit të filmimeve dhe numrin e regjistrueshëm të imazheve statike në kartën e memories.
Version	Afishon versionin e softuerit të kamerës.
Setting Reset	Rikthen cilësimet te cilësimet e parazgjedhura.

Funksionet e „PlayMemories Home“

Softueri „PlayMemories Home“ ju lejon të importoni filmime dhe imazhe statike në kompjuterin tuaj për t'i përdorur ato. Kërkohe „PlayMemories Home“ për importimin e filmimeve AVCHD në kompjuter.



Importimi i imazheve nga kamera



Luajtja e imazheve të importuara



Ndarja e imazheve në „PlayMemories Online“



Për Windows, ofrohen edhe funksionet e mëposhtme.



Shfaqja e imazheve në kalendar



Krijimi i disqeve me filmime



Ngarkimi i imazheve në shërbimet e rrjeti

Instalimi „PlayMemories Home“

Ju mund të instaloni „PlayMemories Home“ nga URL-ja e mëposhtme:
www.sony.net/pm/

Shënime


- Kërkohe lidhje me internetin për të instaluar „PlayMemories Home“.
- Kërkohe lidhje me internetin për të përdorur „PlayMemories Online“ ose shërbime të tjera rrjeti. „PlayMemories Online“ ose shërbime të tjera rrjeti mund të mos ofrohen në disa shtete ose rajone.
- Drejtoju adresës si më poshtë për softuer për Mac:
<http://www.sony.co.jp/imsoft/Mac/>
- Nëse softueri „PMB (Picture Motion Browser)“, që jepet me modelet e qarkulluara përpara 2011, është instaluar tashmë në kompjuter, „PlayMemories Home“ do ta mbishkruajë atë dhe do të instalohet. Përdorni „PlayMemories Home“, softuerin vijues të „PMB“.

■ Instalimi i „PlayMemories Home“ në një kompjuter

- 1 Me anë të shfletuesit të internetit në kompjuter, shkoni në adresën e mëposhtme dhe shtypni [Install] → [Run].
www.sony.net/pm/
- 2 Ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar instalimin.
 - Për detaje mbi „PlayMemories Home“, referojuni faqes së mëposhtme të mbështetjes së PlayMemories Home (vetëm në anglisht):
<http://www.sony.co.jp/pmh-se/>




Shtimi i funksioneve të disponueshme në „PlayMemories Home“

Kur lidhni kamerën me kompjuterin, mund t'i shtohen funksione „PlayMemories Home“. Rekomandojmë që të lidhni kamerën me kompjuterin tuaj edhe nëse „PlayMemories Home“ është i instaluar në kompjuter.



AL

Shënime

- Mos e shkëputni kablion mikro USB (jepet) nga kamera gjatë kohës së përdorimit të ekranit ose kur afishohet ekranit i aksesimit. Duke vepruar kështu mund të dëmtohen të dhënat.
- Për të shkëputur kamerën nga kompjuteri, klikoni  në platformën e detyrave, më pas klikoni  (ikona e shkëputjes). Për Windows Vista, klikoni  në platformën e detyrave.

Funksionet e „Image Data Converter“

Më poshtë jepen shembuj të funksioneve të disponueshme kur përdorni „Image Data Converter“.

- Ju mund të redaktoni imazhe RAW duke përdorur funksione të ndryshme korrigjimi, si p.sh. kurba e tonalitetit ose qartësia.
- Ju mund të rregulloni imazhet duke përdorur balancën e së bardhës, ndriçimin, Creative Style, etj.
- Mund të ruani në kompjuter imazhet statike të shfaqura dhe të redaktuara. Ka dy mënyra për të ruajtur imazhet RAW: mund t'i ruani dhe t'i lini si të dhëna RAW në format skedari të përgjithshëm.
- Mund të shfaqni dhe të krahasoni imazhe RAW / imazhe JPEG të regjistruara me këtë kamera.
- Mund të vlerësoni imazhe në pesë nivele.
- Mund të vendosni etiketën me ngjyra.

Instalimi „Image Data Converter“

1 Shkarkoni softuerin nga URL-ja e mëposhtme dhe instalojeni në kompjuter.

Windows: <http://www.sony.co.jp/imsoft/Win/>

Mac: <http://www.sony.co.jp/imsoft/Mac/>

Shikimi i „Image Data Converter Guide“

Për detaje mbi përdorimin e „Image Data Converter“, referojuni „Image Data Converter Guide“.

1 Për Windows:

Klikoni [Start] → [All Programs] → [Image Data Converter] → [Help] → [Image Data Converter Ver.4].

Për Mac:

Nisni Finder → [Applications] → [Image Data Converter] → [Image Data Converter Ver.4] → Në shiritin e menysë, zgjidhni „Help“ → „Image Data Converter Guide“.

- Për Windows 8, nisni „Image Data Converter Ver.4“ → Në shiritin e menysë, zgjidhni „Help“ → „Image Data Converter Guide“.
- Për detaje mbi „Image Data Converter“, mund t'i referoheni gjithashtu „Udhëzuesi i ndihmës“ (faqe 2) të kamerës ose faqes së mëposhtme të mbështetjes së „Image Data Converter“ (vetëm anglisht):
<http://www.sony.co.jp/ids-se/>

Numri i imazheve statike dhe i kohës së regjistrueshme të filmimeve



Numri i imazheve statike dhe kohës së regjistrueshme mund të variojë në varësi të kushteve të regjistrimit dhe kartës së memories.

■ Imazhe statike

 **Image Size]: L: 20M**

Kur  Aspect Ratio] vendoset në [3:2]*

Quality \ Kapaciteti	2 GB
Standard	295 imazhe
Fine	170 imazhe
Extra fine	125 imazhe
RAW & JPEG	58 imazhe
RAW	88 imazhe

* Kur  Aspect Ratio] vendoset në opsion ndryshe nga [3:2], mund të regjistrimi më shumë imazhe sesa tregohet më lart. (Përveçse kur  Quality] vendoset në [RAW].)

■ Filmimet

Tabela më poshtë tregon kohën maksimale të përafërt të regjistrimit. Kjo është koha totale për të gjithë skedarët e filmimit. Regjistrimi i vazhdueshëm është e mundur për rreth 29 minuta (kufi i specifikimeve të produktit). Koha e regjistrimit maksimal të vazhdueshëm për filmim të formatit MP4 (12M) është rreth 15 minuta (kufizuar nga kufizimi për madhësi maksimale skedari prej 2 GB).

(h (orë), m (minuta))

Record Setting \ Kapaciteti	2 GB
60i 24M(FX)/50i 24M(FX)	10 m
60i 17M(FH)/50i 17M(FH)	10 m
60p 28M(PS)/50p 28M(PS)	9 m
24p 24M(FX)/25p 24M(FX)	10 m
24p 17M(FH)/25p 17M(FH)	10 m
1440×1080 12M	15 m
VGA 3M	1 h 10 m

- Koha e regjistrueshme e filmave ndryshon pasi kamera është e pajisur me VBR (shpejtësi të ndryshueshme bitësh), e cila rregullon automatikisht cilësinë e figurës sipas skenës së regjistrimit. Kur regjistroni subjekte në lëvizje të shpejtë, figura është më e qartë por koha e regjistrimit është më e ulët, pasi kërkohet më tepër memorie për regjistrim. Koha e regjistrueshme ndryshon dhe në varësi të kushteve të regjistrimit, subjektit, ose cilësimeve të cilësisë/madhësisë së figurës.

Shënime mbi përdorimin e kamerës

Funksionet e integruara në kamerë

- Ky manual përshkruan pajisjet që mbështesin 1080 60i dhe 1080 50i. Për të kontrolluar nëse kamera mbështet 1080 60i ose 1080 50i, kontrolloni për shenjat e mëposhtme në fund të kamerës.
Mbështet 1080 60i: 60i
Mbështet 1080 50i: 50i
- Kjo kamerë mbështet filmime në format 1080 60p ose 50p. Ndryshe nga modalitetet standarde të regjistrimit deri më sot, të cilat regjistrojnë në metodën Interlace, kjo kamerë regjistron në metodën Progressive. Kjo rrit rezolucionin dhe ofron një figurë më të shtruar dhe më pranë realitetit.

Përdorimi dhe ruajtja

Shmangni keqtrajtimin, çmontimin, modifikimin, tronditjet fizike, apo goditjet e tilla si me çekiç, rënien apo shkeljen mbi produkt. Tregoni kujdes të veçantë për lentet.

Shënime mbi riprodhimin/regjistrimin

- Përpara se të filloni regjistrimin, bëni një regjistrim provë për t'u siguruar që kamera funksionon siç duhet.
- Kjo kamera është projektuar që t'i rezistojë pluhurit dhe lagështirës, por nuk është e papërshkueshme nga uji apo spërkatjet.
- Mos e drejtoni kamerën nga dielli apo ndonjë burim tjetër ndriçimi i fortë. Kjo mund t'i shkaktojë kamerës defekt.
- Nëse ndodh kondensim lagështirë, largojeni atë përpara se të përdorni kamerën.
- Mos e tundni apo goditni kamerën. Kjo mund të shkaktojë defekt dhe mund të mos jeni në gjendje të regjistroni imazhet. Gjithashtu, media e regjistrimit mund të bëhet e papërdorshme ose mund të dëmtohen të dhënat e imazhit.

Mos e përdorni/ruani kamerën në vendet e mëposhtme

- Në një vend shumë të ngrohtë, të ftohtë ose të lagësht
Në vende të tilla si p.sh. në një makinë të parkuar në diell, trupi i kamerës mund të deformohet dhe kjo mund të shkaktojë keqfunksionim.
- Nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit ose pranë një ngrohësi
Trupi i kamerës mund të deformohet ose të çngjyrosset dhe kjo mund të shkaktojë keqfunksionim.

- Në një vend ku ka dridhje të forta
- Pranë një vendi që krijon valë të forta radioje apo emeton rrezatim, ose që ka fushë të fortë magnetike. Përndryshe, kamera mund të mos i regjistrojë apo riprodhojë siç duhet imazhet.
- Në vende me rërë ose me pluhur
Kini kujdes të mos lini rërën apo pluhurin të hyjë në kamera. Kjo mund të shkaktojë keqfunksionim të kamerës, dhe në disa raste ky defekt mund të jetë i riparueshëm.

Lentja Carl Zeiss

Kamera është e pajisur me një lente Carl Zeiss e cila është në gjendje të riprodhojë imazhe të qarta dhe me kontrast të shkëlqyer. Lentja e kamerës është prodhuar sipas një sistemi të sigurisë së cilësisë të certifikuar nga Carl Zeiss në përputhje me standardet e cilësisë së Carl Zeiss në Gjermani.

Shënime rreth ekranit, treguesit elektronik të kuadrit dhe lentes

- Ekranit LCD dhe treguesi elektronik i kuadrit prodhohen me teknologji me precizion jashtëzakonisht të lartë, dhe rreth 99,99% e pikselëve janë operative për përdorim efikas. Por, mund të qëllojnë disa pika të vogla të zeza dhe/ose të shndritshme (të bardha, të kuqe, të kaltra ose të gjelbra në ngjyrë) që shfaqen në mënyrë në ekran dhe në treguesin elektronik të kuadrit. Këto pika janë rezultat normal i procesit të prodhimit dhe nuk ndikojnë në regjistrim.
- Bëni kujdes të mos i kapni në lente gishtat apo objekte të tjera kur ajo funksionon.

Shënime mbi regjistrimin me treguesin e kuadrit

Kjo kamerë vjen me tregues kuadri me ndriçim organik elektrik, rezolucion të lartë dhe kontrast të lartë. Ky tregues kuadri arrin kënd të gjerë shikimi dhe çlodhje të gjatë të syve. Kjo kamerë është projektuar për të ofruar tregues kuadri me shikim të lehtë, duke balancuar siç duhet elementet e ndryshme.

- Figura mund të deformohet lehtë pranë këndeve të treguesit të kuadrit. Kjo nuk tregon defekt. Kur ju duhet të kontrolloni çdo hollësi të përmbajtjes, mund përdorni dhe ekranin LCD.
- Nëse e panoramoni kamerën ndërsa kërkoni në treguesin e kuadrit ose lëvizni sytë rrotull, imazhi në treguesin e kuadrit mund të shtrembërohet ose mund të ndryshojë ngjyra. Kjo është karakteristikë e lentes ose pajisjes së ekranit dhe nuk është defekt. Kur regjistroni një imazh, rekomandojmë që të shikoni në qendër të treguesit të kuadrit.

Shënime mbi blicin

- Mos e mbani kamerën nga njësia e blicit, ose mos ushtroni forcë të tepërt në të.
- Nëse në njësinë e hapur të blicit hyn ujë, pluhur ose rërë, kjo mund të shkaktojë defekt.
- Bëni kujdes që gishtat apo objekte të tjera të mos kapen kur ulni poshtë blicin.

Rreth temperaturës së kamerës

Kamera dhe bateria mund të nxehen për shkak të përdorimit të vazhdueshëm, por ky nuk përbën defekt.

Reeth mbrojtjes nga mbinxehja

Në varësi të kamerës dhe të temperaturës së baterisë, mund të mos filmoni dot ose energjia mund të fiket automatikisht për të mbrojtur kamerën.

Do të shfaqet një mesazh në ekran përpara se të fiket energjia apo përpara se të mos keni më mundësi filmimi. Në raste të tilla, lëreni pajisjen fikur dhe prisni derisa të bjerë temperatura e kamerës dhe e baterisë. Nëse e ndizni pajisjen pa i lënë kamerën dhe baterinë të ftohen sa duhet, energjia mund të fiket vetë sërish ose mund të mos keni mundësi filmimi.

Reeth karikimit të baterisë

Nëse karikoni një bateri që nuk është përdorur për një kohë të gjatë, mund të mos jeni në gjendje ta karikoni në kapacitetin e saj të plotë.

Kjo ndodh për shkak të karakteristikave të baterisë dhe nuk është defekt. Karikojeni sërish baterinë.

Paralajmërim mbi të drejtat e autorit

Emisionet televizive, filmat, videokasetat dhe materialet e tjera mund të jenë me të drejta autori. Regjistrimi i paautorizuar i këtyre materialeve mund të bjerë ndesh me dispozitat e ligjeve për të drejtat e autorit.

Mungesa e garancisë për materiale të dëmtuara apo problem në regjistrim

Sony nuk ofron garanci në rast problemesh në regjistrim apo dëmtimi të materialeve të regjistruara për shkak defekti me kamerën apo mjetin e regjistrimit etj.

Pastrimi i sipërfaqes së kamerës

Pastrojeni sipërfaqen e kamerës me një pëlhurë të butë të njomur lehtë me ujë, dhe më pas fshijeni sipërfaqen me një pëlhurë të thatë. Për të shmangur dëmtimin e finiturës ose veshjes:

– Mos e ekspozoni kamerën ndaj produkteve kimike si p.sh. hollues, benzinë, alkool, pëlhura kimike, ilaçe kundër insekteve, insekticide ose krem kundër diellit.

Mirëmbajtja e ekranit

- Kremi i duarve ose kremi hidratues i lënë në ekran mund të shpërbëjë veshjen. Nëse mbetet në ekran, fshijeni menjëherë.
- Fshirja me forcë me kartëpecetë apo materiale të tjera mund të dëmtojnë veshjen.
- Nëse në ekran mbeten shenja gishtash apo papastërti, rekomandojmë që të fshini me kujdes çdo papastërti dhe më pas pastrojeni ekranin me një copë të butë.

Shënime mbi rrjetin me valë

Ne nuk marrim asnjë përgjegjësi për çdo dëmtim të shkaktuar nga aksesi i paautorizuar, ose përdorimi i paautorizuar i destinacioneve të ngarkuara në kamerë, si rezultat i humbjes ose vjedhjes.

Shënime mbi hedhjen/transferimin e kamerës

Për të mbrojtur të dhënat personale, kryeni veprimet e mëposhtme kur hidhni apo transferoni kamerën.

- ^{AL}
34 • Rivendosni të gjitha cilësimet e kamerës duke kryer [Setting Reset] (faqe 27).
• Fshini të gjitha fytirat e regjistruara të njerëzve nga [Face Registration] (faqe 24).

Specifikimet

Kamera

[System]

Pajisja e imazhit: Sensor Exmor R
CMOS 13,2 mm × 8,8 mm
(lloji 1.0)

Numri i pikselëve gjithsej të kamerës:
Afërsisht 20,9 megapiksel

Numri efektiv i pikselëve të kamerës:
Afërsisht 20,2 megapiksel

Lentja: Lente zmadhimi Carl Zeiss
Vario-Sonnar T* 8.3×
f = 8,8 mm – 73,3 mm (24 mm –
200 mm (ekuivalent filmi 35 mm))
F2.8

Gjatë regjistrimit të filmimeve
(16:9): 26 mm – 212 mm^{*1}

Gjatë regjistrimit të filmimeve
(4:3): 31 mm – 259 mm^{*1}

^{*1} Kur [] SteadyShot] vendoset
në [Standard]

SteadyShot: optik

Kontrolli i ekspozimit: Ekspozim
automatik, Prioriteti i aperturës,
Prioriteti i diafragmës, Ekspozimi
manual, Zgjedhja e skenave

Balanca e së bardhës: Automatike,
Ndriçim natyral, Hije, Kohë me re,
Inkandeshente, Fluoreshente
(E bardhë e ngrohtë/ E bardhë
e freskët/ E bardhë ditore/ Ndriçim
natyral) Temperatura e ngjyrave/
Filtri i ngjyrave/ Personalizuar

Formati i skedarëve:

Imazhe statike: E pajtueshme me
JPEG (DCF, Exif, MPF Baseline),
e pajtueshme me RAW
(formati Sony ARW 2.3), DPOF
Filmime (format AVCHD):
Mbështet format AVCHD Ver. 2.0
Video: MPEG-4 AVC/H.264

Audio: 2-kanalëshe Dolby Digital,
pajisur me Dolby Digital Stereo
Creator

- Prodhuar me licencë nga
Dolby Laboratories.

Filmime (format MP4):
Video: MPEG-4 AVC/H.264
Audio: 2-kanalëshe
MPEG-4 AAC-LC

Media e regjistrimit: Media „Memory
Stick PRO Duo“, media „Memory
Stick Micro“, karta SD, karta
memorieje microSD

Blici: Gama e blicit (Ndjeshmëria ISO
(treguesi i rekomanduar
i ekspozimit) i vendosur në Auto):
Afërsisht 1,0 m deri 10,2 m
(3,28 ft. deri 33,46 ft.)

AL

[Input and Output connectors]

Kontektori HDMI: Mikrofoleja HDMI
Multiterminali*:

Komunikimi USB

Komunikimi USB: USB e shpejtësisë së
lartë (USB 2.0)

Foleja e mikrofonit: Minifole stereo
Ø 3,5 mm

Foleja e kufjeve: Minifole stereo
Ø 3,5 mm

* Mbështet pajisje me Micro USB.

[Viewfinder]

Lloji: Treguesi elektronik i kuadrit
Numri i pikave gjithsej:

1 440 000 pika

Mbulimi i kuadrit: 100%

Zmadhimi: 0,70 × (me ekuivalent
formati 35 mm) me lente 50 mm
në infinit, -1 m^{-1} (dioptria)

Pika e shikimit: Afërsisht 23 mm nga okulari, 21,5 mm nga korniza e okularit në -1 m^{-1} (dioptria)
Përshtatja e dioptrisë:
 -4.0 m^{-1} deri $+3,0 \text{ m}^{-1}$ (dioptria)

[Screen]

Ekрани LCD:
7,5 cm (lloji 3.0) me bazë TFT
Numri i pikave gjithsej:
1 228 800 pika

[Power, general]

Energjia: Paketë baterie të rikarikueshme
NP-FW50, 7,2 V
Ushqyesi AC-UB10/UB10B/UB10C/UB10D, 5 V
Konsumi i energjisë:
Afërsisht 2,1 W (gjatë regjistrimit me ekran LCD)
Afërsisht 2,7 W (gjatë regjistrimit me tregues kuadri)
Temperatura ku mund të përdoret:
 $0 \text{ }^\circ\text{C}$ deri $40 \text{ }^\circ\text{C}$ ($32 \text{ }^\circ\text{F}$ deri $104 \text{ }^\circ\text{F}$)
Temperatura e ruajtjes: $-20 \text{ }^\circ\text{C}$ deri $+60 \text{ }^\circ\text{C}$ ($-4 \text{ }^\circ\text{F}$ deri $+140 \text{ }^\circ\text{F}$)
Përmasat (mbështetje për CIPA):
 $129.0 \text{ mm} \times 88.1 \text{ mm} \times 102,2 \text{ mm}$
($5 \text{ } 1/8 \text{ inç} \times 3 \text{ } 1/2 \text{ inç} \times 4 \text{ } 1/8 \text{ inç}$)
(GJ/L/TH)
Pesha (mbështetje për CIPA)
(Afërsisht):
813 g (1 lb 12,7 oz) (përfshirë paketë baterie NP-FW50, Media „Memory Stick PRO Duo“)
Mikrofoni: Stereo
Altoperlanti: Mono
Exif Print: Mbështetet
PRINT Image Matching III: Mbështetet

[Wireless LAN]

Standardi i mbështetur:
IEEE 802.11 b/g/n
Frekuenca: 2.4GHz
Protokollet e mbështetura të sigurisë:
WEP/WPA-PSK/WPA2-PSK
Metoda e konfigurimit: WPS (Wi-Fi Protected Setup) / manual
Mënyra e hyrjes: Modalitet „Infrastructure“
NFC: Mbështet NFC Forum Type 3 Tag

Ushqyesi AC-UB10/UB10B/UB10C/UB10D

Kërkesat e ushqimit elektrik: AC 100 V deri 240 V, 50 Hz/60 Hz, 70 mA
Voltazhi në dalje: DC 5 V, 0,5 A
Temperatura ku mund të përdoret:
 $0 \text{ }^\circ\text{C}$ deri $40 \text{ }^\circ\text{C}$ ($32 \text{ }^\circ\text{F}$ deri $104 \text{ }^\circ\text{F}$)
Temperatura e ruajtjes: $-20 \text{ }^\circ\text{C}$ deri $+60 \text{ }^\circ\text{C}$ ($-4 \text{ }^\circ\text{F}$ deri $+140 \text{ }^\circ\text{F}$)
Përmasat (afërsisht):
 $50 \text{ mm} \times 22 \text{ mm} \times 54 \text{ mm}$
($2 \text{ inç} \times 7/8 \text{ inç} \times 2 \text{ } 1/4 \text{ inç}$)
(GJ/L/TH)

Paketë baterie të rikarikueshme NP-FW50

Lloji i baterisë: Bateri me jone litiumi
Voltazhi maksimal: DC 8,4 V
Voltazhi nominal: DC 7,2 V
Voltazhi maksimal i karikimit: DC 8,4 V
Rryma maksimale e karikimit: 1,02 A
Kapaciteti: Tipik 7,7 Wh (1 080 mAh)
Minimumi 7,3 Wh (1 020 mAh)
Përmasat maksimale (Afërsisht):
 $31.8 \text{ mm} \times 18.5 \text{ mm} \times 45 \text{ mm}$
($1 \text{ } 5/16 \text{ inç} \times 3/4 \text{ inç} \times 1 \text{ } 13/16 \text{ inç}$) (GJ/L/TH)

Dizajni dhe specifikimet i nënshtrohen ndryshimit pa dhënë njoftim.

Markat tregtare

- Markat e mëposhtme janë marka tregtare të Sony Corporation. Logoja **Cyber-shot**, „Cyber-shot“, „Memory Stick XC-HG Duo“, „Memory Stick PRO Duo“, „Memory Stick PRO-HG Duo“, „Memory Stick Duo“, „Memory Stick Micro“, „PlayMemories Home“, „PlayMemories Home“, logoja „PlayMemories Online“, „PlayMemories Online“, logoja „PlayMemories Mobile“, „PlayMemories Mobile“
- Logoja „AVCHD Progressive“ dhe „AVCHD Progressive“ janë marka tregtare të Panasonic Corporation dhe Sony Corporation.
- Dolby dhe simboli me dy „D“ janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- Termat HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.
- Windows është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në shtete të tjera.
- Mac është markë e regjistruar tregtare e Apple Inc.
- iOS është markë e regjistruar tregtare ose markë tregtare e Cisco Systems, Inc. dhe/ose e filialeve të saj në SHBA dhe në shtete të tjera të caktuara.
- iPhone dhe iPad janë marka tregtare të Apple Inc. të regjistruara në SHBA dhe në shtete të tjera.
- Logoja SDXC është markë tregtare e SD-3C, LLC.
- Android, Google Play janë marka tregtare të Google Inc.

- Wi-Fi, logoja Wi-Fi, Wi-Fi PROTECTED SET-UP janë marka të regjistruara tregtare të Wi-Fi Alliance.
- Shenja N është markë tregtare ose markë e regjistruar tregtare e NFC Forum, Inc. në SHBA dhe në shtete të tjera.
- DLNA dhe DLNA CERTIFIED janë marka tregtare të Digital Living Network Alliance.
- Facebook dhe logoja „f“ janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Facebook, Inc.
- YouTube dhe logoja YouTube janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Google Inc.
- Eye-Fi është markë tregtare e Eye-Fi, Inc.
- Gjithashtu, emrat e sistemeve dhe të produkteve të përdorura në këtë udhëzues janë, në përgjithësi, marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të zhvilluesve ose prodhuesve përkatës. Por, shenjat TM or [®] nuk përdoren në të gjitha rastet në këtë udhëzues.

AL

Informacioni shtesë mbi këtë produkt dhe përgjigjet e pyetjeve të shpeshta mund të gjenden në uebsajtin tonë të shërbimit të klientit.

<http://www.sony.net/>



<http://www.sony.net/SonyInfo/Support/>